



Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve

**Analizë mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet
financiare, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes
Financiare**

Mars 2021

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
I. Hyrje.....	3
II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve.....	4
A. Tregu i sigurimeve.....	4
1. Informacion mbi primet e shkruara bruto	4
2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit	6
B. Tregu i Kapitaleve	11
1. Tregu me pakicë	11
2. Bursa Shqiptare e Titujve	12
3. Obligacionet me ofertë private	13
C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve.....	15
III. Përfundime	16

I. Hyrje

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” të nënshkruar në muajin prill të vitit 2017, në vazhdimësi angazhohen të ndërmarrin veprime për të ulur nivelin e përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi sipas sektorëve të cilët mbikëqyrin, monitorojnë apo operojnë në aktivitetin e tyre.

Duke qenë se në vendin tonë është krijuar një traditë e përdorimit të gjerë të monedhave të huaja (valutat), kryesisht të Euros dhe dollarit amerikan, masat që duhet të ndërmerren për minimizimin e përdorimit të monedhave të huaja duhet të jenë të kujdesshme dhe të argumentuara, për të qenë efektive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (me tej, Autoriteti) lidhur me përdorimin e monedhave të huaja në tregjet që mbikëqyr, monitoron me kujdes përdorimin e monedhave të huaja në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Lidhur me veprimtarinë në valutë, në këtë raport janë përfshirë:

Informacion për tregun e sigurimeve sipas produkteve dhe investimeve nga shoqëritë, informacion për fondet e investimeve dhe të pensioneve private vullnetare. Disa nga produktet financiare të këtyre institucioneve, operojnë në valutë për arsye objektive.

Të tillë janë, për shembull disa produkte të sigurimit të detyrueshëm motorik, si polica kufitare dhe kartoni jeshil. Produkti i Kartonit Jeshil është produkt ndërkombëtar sigurimi, i cili lëshohet në monedhën Euro, pasi edhe detyrimet që i lindin shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për pagesë dëmshpërblimi nga ky sigurim janë në Euro. Polica kufitare lëshohet në pikat e kalimit kufitar gjatë hyrjes së automjeteve me targa të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pagesa e primit të policës në monedhën vendase do të vështirësonte procesin e pajisjes së konsumatorit me këtë policë sigurimi. Po kështu, disa nga produktet kryesore të aktivitetit të sigurimit, si sigurimi i pronës me përfitues bankat tregtare ose sigurimi i Jetës së debitorit, janë të lidhura ngushtësisht me monedhën e kredisë. Monedha në të cilën disbursohet kredia dikton dhe monedhën e lëshimit të policës, për shkak të nevojës për të rikuperuar në të njëjtën monedhë vlerën e detyrimit, në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Tek fondet e investimit, në disa prej tyre, natyra e profilit të veprimtarisë kërkon investimin e tyre në aksione apo tituj të tregjeve ndërkombëtare, pra realizohet në valutë. Gjatë vitit 2020 vihet re një rënie e aseteve neto të fondeve të investimit në monedhë të huaj.

II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve

A. Tregu i sigurimeve

1. Informacion mbi primet e shkruara bruto

Referuar të dhënave për 31.12.2020, primet e shkruara bruto¹ për të gjithë aktivitetin e tregut të sigurimeve Jo-Jetë dhe Jetë rezultojnë në rreth 16.6 miliardë lekë. Rreth 27% e tyre është realizuar në monedhën Euro.

Në mënyrë të detajuar, vihet re se përveç produkteve të detyrueshme të Kartonit Jeshil dhe Sigurimi Kufitar, ka edhe disa produkte vullnetare që rezultojnë me të ardhura pothuajse 100% të realizuara në Euro, siç është Sigurimi i kombinuar i Aksidenteve personale dhe shëndetit, Sigurimi i Jetës në Udhëtim dhe Sigurimi i Jetës së Studentit. Gjithashtu, produktet që shfaqin një vlerë të primeve të shkruara në përqindje të lartë në Euro janë: Sigurimi Kasko, Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit, Sigurimi i Pronës, Sigurimi Inxhinierik, si: Sigurimi i të Gjitha Risqeve në Ndërtim (CAR)² në aktivitetin e sigurimit Jo-Jetë dhe Sigurimi i Jetës me Kursim, Sigurimi “Cash Plan”³ dhe “Flexi Plan”⁴ për Sigurimin e Jetës. Ndërkohë, produktet si Sigurimi i Mallit në Transport apo Sigurimet Inxhinierike paraqesin një nivel të lartë Euroizimi për shkak të interesit të siguruar nga këto kontrata, interes i cili vlerësohet kryesisht në Euro në rastet e import-eksporteve dhe sigurimeve inxhinierike që përfshijnë vepra madhore të infrastrukturës, përfshirë ato me shoqëri ndërkombëtare.

Referuar grafikut 1, në 31.12.2020 pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë ka pësuar rënie me rreth 5% krahasuar me fundvitin 2019, duke shkruar në rreth 26% nga 31%. Ndikimi kryesor vjen nga rënia e primeve të shkruara, me rreth 8 milionë euro apo -44.8% krahasuar me vitin 2019, në linjat e sigurimit të detyrueshëm Karton Jeshil e Sigurim Kufitar, për shkak të kufizimit të lëvizjes.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 31.12.2020, klasat që kanë shfaqur rënie më të theksuar të primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2019, janë: Sigurimet Inxhinierike, me rënie të peshës me 17.71% (nga 89.1% në 71.39%), Sigurimi i Marinës, me rënie me 10.37% (nga 12.5% në 2.1%), Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit, me rënie 4.92% (nga 66.2% në 61.3%) pasuar nga Sigurimi i Garancisë, me rënie 4.07% (nga 19.9% në 15.81%). Ndërkohë, rënie në peshë të klasave të sipërpërmenduar në 31.12.2020 janë balancuar disi nga rritja e peshës së primeve të shkruara bruto në Euro kundrejt totalit të primeve të shkruara në krahasim

¹ Primet e shkruara bruto janë të ardhura për shoqëritë e sigurimit dhe si të tilla, këto dy terma përdoren në këtë material si zëvendësues të njëri-tjetrit.


² Produkt Sigurimi Jo-Jetë, i cili ofron mbulimin me sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e ndërtimit të objekteve dhe gjithashtu edhe për një afat garancie pas përfundimit të punimeve.

³ Produkt Sigurimi Jete, i cili garanton mbulimin e shpenzimeve për problemet shëndetësore të paparashikuara të personit të siguruar.

⁴ Produkt Sigurimi Jete, i cili mbulon humbjen e jetës si pasojë e aksidentit, humbjen e jetës nga faktorë natyrorë, paaftësinë e përhershme të plotë, paaftësinë e përhershme të pjesshme, etj.

me 31.12.2019, për: Sigurimin e Pronës me rritje të peshës me 8.29% (nga 44.6% në 52.89%) dhe Sigurimin e Mallit në Transport me rritje të peshës me 6.59% (nga 62.8% në 69.42%).

Grafik 1: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit Jo-Jetë në EUR kundrejt totalit




Referuar grafikut të mëposhtëm, në 31.12.2020, pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt primeve të shkruara bruto në total për aktivitetin e Jetës ka shënuar një rritje modeste me rreth 2%, duke arritur në 37.46%, nga 35.36% që ka qenë në 31.12.2019.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 31.12.2020, klasat që kanë shfaqur rënie më të theksuar të primeve të shkruar në Euro në krahasim me 31.12.2019, janë: Sigurimi me elemente kursimi me rënie të peshës me 39% (nga 94% në 55%), si dhe Sigurimi “Cash Plan” rezultojnë një rënie prej 12% (nga 74% në 62%). Ndërkohë për: Sigurimin e Kombinuar të Jetës⁵ me rritje të peshës me 10% (nga 23% në 33%) dhe Sigurimin e Jetës së Debitorit⁶ me rritje me 6% (nga 24% në 30%).

⁵ Produkt Sigurimi Jete, i cili kombinon sigurimin e jetës dhe sigurimin ndaj sëmundjeve kritike.

⁶ Produkt Sigurimi Jete, i cili mbulon rrezikun e mos shlyrjes së hua-së, si pasojë e humbjes së jetës së huamarrësit.

Grafik 2: Peshë e primeve të aktivitetit të sigurimit të Jetës në EUR kundrejt totalit



2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit

Depozitat e shoqërive të sigurimit për periudhën 31.12.2020, të investuara në monedhat Lekë dhe valutë të huaj, rezultojnë në vlerë totale rreth 12 miliardë Lekë.


Nga këto depozita në monedhën vendase Lekë janë investuar rreth 6.90 miliardë Lekë, ose rreth 56% të totalit të depozitave, ndërsa ato në valutë rezultojnë të jenë rreth 5.34 miliardë Lekë, ose rreth 44 % të vlerës totale të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat zënë rreth 86.3 % të depozitave totale në valutë dhe 37.6 % të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2019, depozitat në valutë shënojnë një rënie të lehtë në vlerë me 0.88 miliardë Lekë dhe në peshë me 4% ndaj totalit të depozitave të shoqërive të sigurimit.


Në mln Lekë

	Depozita në LEK		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2020
TREGU TOTAL	5,919	6,908	399	733	5,025	4,604

Grafik 3: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve në total



Grafik 4: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



a) Tregu i sigurimeve Jo-Jetë


Përsa i përket tregut të sigurimit jo-jetë, për periudhën 31.12.2020, rreth 4.80 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose rreth 49% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 4.95 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 51% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat kapin vlerën rreth 34 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 4.25 miliardë Lekë dhe zënë rreth 85.6 % të depozitave totale në valutë dhe 43.5% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2019, depozitat në valutë kanë shënuar rritje të lehtë prej 2% ndaj totalit të depozitave. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga rritja e depozitave në USD.


Në mln Lekë

	Depozita në LEK		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2020
TREGU JO-JETË	4,710	4,799	306	712	4,107	4,247

Grafik 5: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve Jo-Jetë



Grafik 6: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



b) Tregu i sigurimeve të Jetës


Përsa i përket tregut të sigurimit të Jetës, rreth 2.10 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose rreth 85% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 0.38 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 15% kundrejt totalit të depozitave.

Në mln Lekë


	Depozita në LEK		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2019	31.12.2020
TREGU JETË	1,208	2,109	94	21	918	357

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat arrijnë vlerën rreth 2.88 milionë Euro, ose kundrvlerën rreth 357 milionë Lekë dhe zënë rreth 94.4% të depozitave totale në valutë dhe 14.4% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Pësja e depozitave në valutë në raport me depozitat totale ka pësuar rënie të konsiderueshme në krahasim me fundin e vitit 2019. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i ndryshimeve në strukturën e investimeve të një nga shoqëritë e Jetës, e cila ka shtuar depozitat në lekë me 6.74 miliard lekë duke pakësuar ato në USD dhe Euro me kundërvlerën në lekë përkatësisht 0.65 miliard lekë dhe 6.17 miliard lekë.

Grafik 7: Vlera e depozitave në Lek dhe valutë për tregun e sigurimeve të Jetës



Grafik 8: Pesha e depozitave në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave




B. Tregu i Kapitaleve

Tregu Shqiptar i Kapitaleve, i mbizotëruar nga titujt e borxhit të qeverisë që janë kryesisht në lekë, karakterizohet nga një shkallë tepër e ulët e euroizimit. Pjesëmarrësit kryesorë në këtë treg përdorin kryesisht monedhën vendase. Megjithatë ka edhe emëtues privatë të titujve që kanë kryer emëtime në valutë. Autoriteti monitoron këtë treg, për të vlerësuar ecurinë e treguesve dhe nevojën për masa specifike.


1. Tregu me pakicë

Të dhënat e tregut me pakicë përfshijnë tregtimin e titujve të borxhit të Qeverisë mes bankave të licencuara dhe investitorëve individuale apo personave juridikë, në lekë dhe monedhën Euro. Tregu me pakicë dominohet nga blerjet e bankave në tregun primar për llogari të investitorëve. Ashtu siç shihet dhe në grafikun e mëposhtëm, për vitin 2020, vlera e transaksioneve në Euro është rritur. Kjo për faktin se gjatë kësaj periudhe ka patur emetime të titujve të Qeverisë Shqiptare (obligacione 2-vjeçare) në Euro. Vlera prej 1,078 milion lekë i takon transaksioneve në tregun primar dhe sekondar (shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar dhe blerje para afatit të maturimit) të obligacioneve 2-vjeçare në Euro. Në vitin 2019 nuk ka patur emetime të titujve në Euro. Vlera prej 547 milionë lekë i takon transaksioneve në tregun sekondar të obligacioneve 2-vjeçare (blerje nga ndërmjetësi financiar para afatit të maturimit), përfshirë edhe shumën e shlyerjes në maturim.

Grafik 9: Tregu me Pakicë i titujve të Qeverisë




Grafik 10: Tregu me Pakicë i titujve të Qeverisë (Në %)



2. Bursa Shqiptare e Titujve

Në Bursën Shqiptare të Titujve (ALSE), gjatë vitit 2019 dhe vitit 2020 janë realizuar vetëm transaksione në tituj të Qeverisë Shqiptare, të nominuar në lekë.


Grafik 11: Pesha e transaksioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të transaksioneve në Bursën Shqiptare të Titujve




3. Obligacionet me ofertë private

Tregu i kapitaleve iu ofron shoqërive aksionare mundësi për sigurimin e fondeve të financimit për biznesin e tyre. Duke filluar nga dhjetori 2011, emetimi i obligacioneve nëpërmjet ofertave private ka qënë një burim financimi për banka, institucione financiare dhe shoqëri tregtare. Obligacionet janë emëtuar në monedhën vendase dhe në valutë të huaj (EUR dhe USD). Totali i shumës së pashlyer të obligacioneve të emëtuar nëpërmjet ofertave private në fund të vitit 2020 është: 8,025 milionë lekë, nga të cilat 43.3 % janë në Euro (ekuivalenti në lekë 3,475 milionë) dhe 7,2 % në USD (ekuivalenti në lekë 578.8 milionë). Gjatë vitit 2020 vihet re një rritje e obligacioneve me ofertë private të emetuara në valutë.

Grafik 12: Obligacionet me ofertë private të emetuara dhe të pashlyera



Grafik 13: Pesha e obligacioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të obligacioneve me ofertë private të emetuara dhe të pashlyera




C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve


Në 31.12.2020, në tregun e fondeve të investimit operuan shtatë fonde, nga të cilët pesë fonde investimi kryejnë veprimtarinë në monedhën vendase Lekë. Dy nga fondet e investimit (një i licencuar në Tetor 2020) kryejnë të gjithë aktivitetin në monedhën Euro, ndërsa një tjetër fond investimi kryen vetëm investimin e aseteve në monedha të huaja, kryesisht në monedhën Euro.

Asetet e Fondeve, të cilët kryejnë të gjithë aktivitetin e tyre në monedhën Euro duke nisur që nga mbledhja e kontributeve të anëtarëve, investimet e aseteve të fondit, tarifa e administrimit si dhe shlyerjet ndaj investorëve, janë rreth 71 milionë Euro dhe zënë rreth 13.02% të totalit të aseteve të tregut. Edhe detyrimet e këtyre fondeve, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj shoqërisë administruese për tarifën e administrimit dhe detyrime për pagesat ndaj kuota mbajtësit, mbahen përsëri në monedhën Euro dhe zënë rreth 10.07% të detyrimeve të tregut. Katër fondet e tjera të investimit të cilat operojnë në monedhën lekë nuk kanë investime në monedhën Euro dhe të gjithë asetet dhe detyrimet mbahen në monedhën vendase lekë.

Gjatë vitit 2020 asetet neto të fondeve në Euro kanë pësuar rënie në krahasim me fundvitin 2019. Rënia e aseteve neto në Euro e shprehur në lekë për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ishte 938 milion lekë ose -9.65%.

Grafik 14: Vlera Neto e Aseteve të fondeve të investimit





Sa i përket fondeve të pensioneve vullnetare, ato e kryejnë tërësisht aktivitetin e tyre në lekë.

III. Përfundime

Pesha e vlerës së asetëve që administrohen prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti është relativisht e ulët. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e mësipërme, niveli aktual i përdorimit të valutës (Euro-s) në tregjet e mbikëqyrura nga AMF është në nivele përgjithësisht të ulëta dhe i diktuar nga profili i veprimtarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Autoriteti do të monitorojë zhvillimet në këto tregje dhe më konkretisht do të fokusohet në drejtim të rritjes së transparencës për produktet që iu ofrohen *investitorëve*, veçanërisht në drejtim të evidentimit dhe kuptimit sa më të qartë të rrezikut (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) të kursit të këmbimit.